

## Vendim nr.141, datë 06.05.2026

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Asim Vokshi, Marjana Semini, Anëtarë, në datën 06.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (S) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** SAFET GJICI, përfaqësuar nga avokati Jordan Daci, me prokurë të posaçme.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 8, datë 07.02.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 25, datë 24.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; nr. 00-2025-1446, datë 25.09.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 5, 7, 29, 30, 32, 42, 43, 81, 112, 116, 122, 131, pika 1, shkronja “f”, 135, 142, 145 dhe 148 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 7 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka ushtruar detyrën e kryetarit të Bashkisë së Kukësit. Prokuroria e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar procedimin penal nr. 145/2023, në vijim të një videoje të publikuar *online* në media/portale të ndryshme, nga e cila ka rezultuar se në datën 06.06.2023 kërkuesi ka kryer marrëdhënie seksuale me shtetasen A.K. në zyrën e tij. Në ngarkim të kërkuesit ka filluar procedimi penal për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (*KP*). Më tej, në datën 22.06.2023, Prokuroria e Posaçme ka pasqyruar në regjistër ndryshimin e cilësimit juridik të veprës nga “Shpërdorimi i detyrës” në “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuar nga neni 260 i *KP*-së, në ngarkim të kërkuesit, dhe “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuar nga neni 245 i *KP*-së, në ngarkim të personit nën hetim A.K.

2. Në përfundim të hetimeve paraprake Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) me kërkesë për gjykimin e kërkuesit dhe të pandehurës A.K., të akuzuar për kryerjen respektivisht të veprave penale të parashikuara nga nenet 260 dhe 245 të *KP*-së, duke pretenduar, në thelb se, akti seksual ka qenë përfitim për kërkuesin në cilësinë e kryetarit të Bashkisë së Kukësit dhe është kryer kundrejt dhënies së projektit “Kafshët e pastreha dhe ndihma humane që duhet t’u japim këtyre kafshëve” që kërkonte të merrte e pandehura A.K. nga kjo bashki, përfituese eventuale e projektit.

3. Në përfundim të gjyimit të çështjes, me vendimin nr. 8, datë 07.02.2024 (*vendimi nr. 8/2024*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i *KP*-së, dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*) uljen e 1/3-ës së dënimit, duke e dënuar kërkuesin përfundimisht me 2 vjet burgim. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim kërkuesi dhe Prokuroria e Posaçme.

4. Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 25, datë 24.06.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, deklarinin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuar nga neni 260

i KP-së, dhe dënimin e tij me 4 vjet e 6 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406 të KPP-së, uljen e 1/3-ës së dënimit, duke e dënuar kërkuesin përfundimisht me 3 vjet burgim.

5. Për rekursin e kërkuesit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1446, datë 25.09.2025, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

6. Në datën 23.02.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Ndërsa në datën 21.04.2026 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt* në drejtim të:
- 7.1. *Së drejtës për t'u mbrojtur*, pasi GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar kualifikimin e veprës penale nga “Shpërdorimi i detyrës” në “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, pa e rikthyer çështjen për gjykim në gjykatën e shkallës së parë dhe pa i dhënë mundësi kërkuesit për t'u mbrojtur për akuzën e re, të parashikuar nga neni 260 i KP-së. Gjykata e Lartë ka lënë në fuqi vendimin e GJKKO-së së Apelit, duke pranuar rikualifikimin e veprës penale, me arsyetimin se marrja e shërbimit seksual ishte provë e korrupsionit.
- 7.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi GJKKO-ja e Apelit ka përfshirë në faktin penal ngjarjet e datës 23.05.2025, megjithëse prokuroria e kishte kufizuar akuzën në takimin e datës 06.06.2023, duke marrë kështu funksionin e organit të akuzës. Legjislacioni penal nuk i lejon gjykatës në asnjë rast që në vendimin e saj mund të ngrejë/ndryshojë akuzën duke përdorur fakte përtej faktit penal të paraqitur nga prokurori, pasi bie ndesh me funksionin e saj.
- 7.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi në fashikullin e gjykimit të Gjykatës së Lartë gjendet një shkresë e kancelarit të asaj gjykate për kalimin e çështjes gjyqtarit të caktuar për shqyrtimin e saj. Akti i caktimit të gjyqtarit përmban edhe datën e zhvillimit të gjykimit në dhomën e këshillimit, çka do të thotë se hedhja me short mund të jetë bërë pasi fashikulli i ka kaluar në mënyrë të paligjshme gjyqtarit relator.

- 7.4. *Parimit për gjykim të drejtë*, pasi në fashikullin e Gjykatës së Lartë mungon regjistrimi audio i gjykimit në dhomën e këshillimit, sipas udhëzimit nr. 353, datë 03.09.2013 të ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”. Po kështu, procesverbali i dhomës së këshillimit nuk përmban elementet e kërkuara nga neni 115 i KPP-së dhe mungon në tërësi transparenca e procesit, fakte këto të cilat krijojnë dyshime për paanësinë e gjykatës.
- 7.5. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi GJKKO-ja e Apelit: i) është mbështetur kryesisht në deklaratimet e të pandehurës A.K., duke mos marrë në konsideratë pretendimet e mbrojtjes për mungesën e diskutimit zyrtar për projektin dhe ekzistencën e veprimeve që do të ishte vijimësi e përfitimit të ndërsjellët; ii) nuk i ka garantuar mundësinë dhe mjetet procedurale për ushtrimin e mbrojtjes, qoftë nëpërmjet kundërshtimit të provave ose konkluzioneve të saj, ashtu edhe nëpërmjet paraqitjes dhe administrimit të provave të tjera.
- 7.6. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi asnjë nga gjykatat e posaçme dhe Gjykata e Lartë nuk kanë argumentuar për kundërshtimet thelbësore të mbrojtjes për mungesën e elementeve të anës objektive dhe anës subjektive të veprës penale, për të cilën është dënuar. Po kështu, gjykatat nuk kanë arsyetuar në mënyrë shteruese për provimin e fajësisë tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ato kanë krijuar një konfuzion mes kualifikimit ligjor dhe fakteve. Në vendimmarrjet e tyre janë cituar vetëm ato prova që mbështesin fajësinë, duke anashkaluar provat e kërkuar dhe përse ato konsiderohen si të parëndësishme.
- 7.7. *Parimit të mosdënimit pa ligj*, të garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, pasi interpretimi i zgjeruar që GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bërë nenit 260 të KP-së, duke e cilësuar marrëdhënien seksuale si “përfitim të parregullt”, cenon *parimin e sigurisë juridike* dhe përbën ndëshkim pa ligj. Duke e barazuar marrëdhënien seksuale me “përfitim të parregullt”, këto gjykata i kanë dhënë konceptit penal një përmbajtje të re, që nuk del nga teksti i ligjit. Neni 260 i KP-së nuk ndalon dhe as nuk përmend marrëdhëniet intime si lloj përfitimi.
- 7.8. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi GJKKO-ja e Apelit e ka deklaruar fajtor kërkuar për veprën penale të parashikuar nga neni 260 i KP-së, duke bërë një interpretim të zgjeruar të anës objektive dhe asaj

subjektive të figurës së kësaj vepre. Në rastin konkret, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se projekti nuk ishte objekt i një marrëveshjeje korruptive dhe nuk ishte dhënë asnjë favor për të. Gjatë gjykimit në gjykatat e faktit është provuar vazhdimësia e një marrëdhënieje konsensuale pa qëllime përfitimi. Po kështu, mungojnë edhe elementet e anës objektive dhe asaj subjektive të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, pasi në rastin konkret nuk ka veprim të kundërligjshëm. Një marrëdhënie seksuale konsensuale nuk përbën mitë ose avantazh të njëanshëm, nuk ka vlerë të matshme, nuk lidhet me ushtrimin e funksionit, si dhe nuk është e ndaluar nga ligji. Në këtë situatë, ajo nuk mund të përbëjë “përfitim të parregullt”, në kuptim të nenit 260 të KP-së, dhe as “shpërdorim detyre”, në kuptim të nenit 248 të këtij kodi, sepse mungojnë elementet e anës objektive të këtyre veprave penale. Në dhënien e vendimit, GJKKO-ja e Apelit është mbështetur në deklaratat e të bashkëpandehurës A.K. të marra përpara se ajo të akuzohej, duke i vlerësuar si dëshmi dhe si deklarata që e inkriminonin vetë atë. Edhe Gjykata e Lartë ka vlerësuar se fajësia është provuar me prova të mjaftueshme, por nuk ka identifikuar se cilat ishin ato.

- 7.9. *Së drejtës për jetë private dhe mbrojtjes së imazhit*, të garantuar nga neni 8 i KEDNJ-së, pasi GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka identifikuar që videoja ishte bërë pa vendim gjyqësor, duke shkaktuar ndërhyrje në jetën e tij private.

### III

#### Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 61, date 19.09.2024; nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Për sa i përket këtij kriteri, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se pretendimin për cenimin e *së drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e imazhit*, si rrjedhojë e mosidentifikimit nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë që videoja ishte bërë pa vendim gjyqësor, kërkuesi nuk e ka ngritur në rekursin e tij drejtuar Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se për këtë pretendim ai nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

12. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

13. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit, ai i Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor të kundërshtuar, mban datën 25.09.2025 dhe i është komunikuar avokatit të kërkuesit në datën 26.11.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 23.02.2026, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se pretendimet e kërkuesit parashtrohen në kuadër të *së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës (në aspekt të *së drejtës për t’u mbrojtur, së drejtës për t’u*

*gjykuar nga një gjykatë e paanshme, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit për gjykim të drejtë, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, standardit të arsytimit të vendimit), si dhe parimit të mosdënimit pa ligj e të parimit të prezumimit të pafajësisë, të garantuara nga nenet 29 dhe 30 të Kushtetutës.*

15. Në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për t'u mbrojtur, me argumentin se GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar kualifikimin e veprës penale nga “Shpërdorimi i detyrës” në “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, pa e rikthyer çështjen në gjykatën e shkallës së parë dhe pa i dhënë mundësinë atij për t'u mbrojtur për akuzën e re. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se edhe GJKKO-ja e Apelit ka përfshirë në faktin penal ngjarjet e datës 23.05.2025, megjithëse prokuroria e kishte kufizuar akuzën në takimin e datës 06.06.2023, duke përdorur fakte përtej atyre të paraqitura për gjykim nga prokurori, në cenim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme.

16. Për sa u përket pretendimeve për paanshmërinë e GJKKO-së së Apelit, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën kushtetuese për paanshmërinë e gjykatës, sipas së cilës e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëjës prej palëve; një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur; e drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*), Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se ato parashtrohen, në thelb, në drejtim të vlerësimit të fakteve penale nga GJKKO-ja e Apelit që nuk ishin evidentuar si të tilla nga organi i akuzës, pra në kuadër të kualifikimit prej saj të veprës penale. Duke pasur parasysh se i njëjti pretendim parashtrohet nga kërkuesi edhe për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon t'i analizojë së bashku.

17. Në jurisprudencën kushtetuese Gjykata ka evidentuar se e drejta e mbrojtjes duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se Prokuroria e Posaçme ka kërkuar gjykimin e kërkuarit për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuar nga neni 260 i KP-së. Gjatë seancës paraprake kërkuari ka kërkuar të procedohet me gjykim të shkurtuar, kërkesë që është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, e cila, në përfundim të gjykimit, e ka deklaruar fajtor për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Ndaj këtij vendimi kanë paraqitur ankim si kërkuari, ashtu edhe organi i ndjekjes penale dhe, në përfundim të shqyrtimit të tyre, GJKKO-ja e Apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke e deklaruar kërkuarin fajtor për veprën penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të kërkuar nga organi i akuzës. Lidhur me pretendimin e ngritur nga kërkuari për cenimin e së drejtës së mbrojtjes, si rrjedhojë e përfshirjes në faktin penal historik të ngjarjeve që i përkasin periudhës përpara datës 06.06.2023 dhe ndryshimit të cilësimit të veprës penale nga gjykata e apelit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, ka vlerësuar se do të kishte cenim të ushtrimit të ndjekjes penale vetëm në rastet kur gjatë shqyrtimit gjyqësor do të dilte një fakt i ri në ngarkim të kërkuarit, i papërmendur në kërkesën për gjykim dhe, në mungesë të çdo nisme procedurale nga prokurori sipas nenit 374 të KPP-së, gjykata do ta dënonte atë për një fakt të ri, të ndryshëm nga ai i paraqitur për gjykim. Në kundërshtim nga sa kërkuari pretendonte, një situatë e tillë nuk evidentohet në rastin konkret, jo vetëm për shkak se fakti i përmendur (takimi i datës 23.05.2023 dhe marrëdhënia seksuale e konsumuar në atë datë në funksion të kërkesës së shtetasës A.K. për mbështetje nga Bashkia e Kukësit) nuk kishte dalë rishtazi gjatë shqyrtimit gjyqësor, pasi çështja ishte gjykuar me gjykim të shkurtuar mbi bazën e akteve të hetimit paraprak, por edhe se i gjykuari nuk ishte dënuar dy herë për të njëjtën veprë penale, atë të parashikuar nga neni 260 i KP-së (*shih paragrafin 20 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

19. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuari ka pasur dijëni për veprën penale për të cilën është akuzuar, të parashikuar nga neni 260 i KP-së, si në aktin e njoftimit të akuzës, ashtu edhe në kërkesën për gjykim, duke i pasur kështu të gjitha mundësitë për të ushtruar mbrojtjen e tij në GJKKO-në e Shkallës së Parë, bazuar në gjendjen që ishin aktet, për këtë akuzë. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se, mbi bazën e ankimit të organit të akuzës, GJKKO-ja e Apelit, mbi të njëjtat fakte objekt akuze, ka ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale nga shpërdorimi i detyrës në atë të korrupsionit pasiv, duke vlerësuar se, në ndryshim nga sa kishte arsyetuar GJKKO-ja e Shkallës së Parë, cilësimi juridik i veprimeve të kryera nga kërkuari si

elemente të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, nuk ishte bërë drejt nga ajo gjykatë. Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se në arritjen e këtij përfundimi GJKKO-ja e Apelit ka vepruar brenda kompetencave të saj, të parashikuara nga neni 425, pika 2, shkronja “a”, i KPP-së. Për më tepër, kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar për këtë pretendim edhe nga Gjykata e Lartë, arsyetim i cili nuk rezulton të jetë arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t’u mbrojtur, për këtë shkak, është haptazi i pabazuar.

20. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, duke parashtruar si shkak se caktimi i gjyqtarit relator në Gjykatën e Lartë mund të jetë bërë pa short, në kundërshtim me rregullat në fuqi. Po kështu, ai ka pretenduar edhe cenimin e parimit të gjykimit të drejtë, pasi në fashikullin e Gjykatës së Lartë mungon regjistrimi audio i gjykimit në dhomën e këshillimit dhe informacioni për transparencën e procesit në tërësi.

21. Për sa i përket pretendimit për shortimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, Mbledhja e Gjyqtarëve sjell në vëmendje jurisprudencën kushtetuese, sipas së cilës, në sensin material, “gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj” karakterizohet nga funksioni gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 55, datë 07.11.2023; nr. 7, datë 23.02.2021; nr. 27, datë 24.06.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Procedurat për caktimin e gjyqtarëve në përbërje të trupit gjykues normohen në aktet ligjore dhe nënligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor, sipas të cilave kompetencën për të caktuar gjyqtarët në seksione dhe trupa gjykues në çdo gjykatë e ka këshilli i gjykatës, pasi merr mendimin e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve, duke ndjekur rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (*shkronja “ç” e nenit 38 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar*).

23. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të shqyrtimit paraprak të kërkesës, rezulton se gjyqtari relator i çështjes në Gjykatën e Lartë është përcaktuar me short në datën 20.09.2024, në momentin e regjistrimit të çështjes në atë gjykatë. Pra, në ndryshim nga sa kërkuesi pretendon, formimi i trupit gjykues dhe

caktimi i gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë është kryer në përputhje me parashikimet e akteve nënligjore që normojnë veprimtarinë administrative dhe gjyqësore të asaj gjykate. Nga ana tjetër, kërkuesi nuk ka dhënë argumente sesi caktimi i gjyqtarit relator ka ndikuar në të drejtat e tij dhe, po kështu, nuk rezulton që ai, gjatë kohës që rekursi ishte në pritje për shqyrtim, të ketë paraqitur ndonjë kërkesë për përjashtimin e tij. Rrjedhimisht, argumenti për sa i takon cenimit të së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj haptazi nuk qëndron.

24. Për sa i përket pretendimit se në dosjen e Gjykatës së Lartë mungon regjistrimi audio dhe procesverbal i dhomës së këshillimit nuk përmban elementet e kërkuara nga neni 115 i KPP-së dhe mungon në tërësi transparencja e procesit të zhvilluar në atë gjykatë, krahas faktit se ky pretendim ka të bëjë me çështje të zbatimit të ligjit, të cilat nuk përshihen në juridiksionin kushtetues, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesi nuk ka përcaktuar në aspektin kushtetues pasojat e ardhura për këtë shkak në të drejtat e tij themelore. Për rrjedhojë, në kushtet kur ky pretendim nuk është argumentuar në këndvështrimin kushtetues, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ai nuk mund të merret në shqyrtim.

25. Në ankimin kushtetues individual kërkuesi ka pretenduar *cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, duke parashtruar se në deklarinë fajtor të tij GJKKO-ja e Apelit: (i) është mbështetur kryesisht në deklarinë të pandehurës A.K.; (ii) nuk i ka garantuar mundësinë dhe mjetet procedurale për ushtrimin e mbrojtjes, qoftë nëpërmjet kundërshtimit të provave ose konkluzioneve të saj, ashtu edhe nëpërmjet paraqitjes dhe administrimit të provave të tjera.

26. Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se me kërkesë të kërkuesit gjykimi në gjykatat e zakonshme është zhvilluar me gjykim të shkurtuar, në të cilin, siç ka pohuar Gjykata, ky lloj gjykimi konsiston në heqjen dorë në mënyrë të vullnetshme dhe të shprehur nga ana e të pandehurit nga disa aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të tilla, si, parimi i barazisë së armëve dhe ai i formimit të provës në kontradiktoritet, në këmbim të një sërë avantazhesh që atij i garantohen nga legjislacioni i brendshëm, pra për të përfituar një ulje të dënimit (*shih vendimin nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, në kushtet kur me kërkesë të tij kërkuesi ka hequr dorë nga disa aspekte të së drejtës për proces të rregullt ligjor, ndër to për kundërshtimin dhe administrimin provave të reja, tej atyre të administruara në fashikullin e prokurorit, pretendimet e tij për *cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit* nuk mund të merren në shqyrtim.

27. Për sa u përket pretendimeve të tjera për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* dhe *parimit të mosdënimit pa ligj*, duke pasur parasysh argumentet në themel të tyre, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon që ato të analizohen në vijim, të lidhura së bashku.

28. Për sa më sipër, në vijim, Mbledhja e Gjyqtarëve do të analizojë pretendimet e kërkuarit për cenimin e *së drejtës së mosdënimit pa ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, si dhe pretendimet për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, të cilat *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

*B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mosdënimit pa ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*

29. Kërkuari ka pretenduar se interpretimi i zgjeruar që GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bërë nenit 260 të KP-së, duke e cilësuar marrëdhënien seksuale si “përfitim të parregullt”, përbën dënim pa ligj. Duke e barazuar marrëdhënien seksuale me “përfitim të parregullt”, këto gjykata i ka dhënë konceptit penal një përmbajtje të re që nuk del nga teksti i ligjit. Neni 260 i KP-së nuk ndalon dhe as nuk përmend marrëdhëniet intime si lloj përfitimi.

30. Kushtetuta në katalogun e të drejtave themelore ka parashikuar, ndër të tjera, se askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj (*neni 29, pika 1*) dhe se ndaj akuzave të ngritura, kushdo ka të drejtën e një gjykimi të drejtë (*neni 42, pika 2*), ndërsa vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara (*neni 142, pika 1*).

31. Gjykata ka theksuar se e drejta për të mos u dënuar pa ligj, e sanksionuar në nenin 29 të Kushtetutës dhe në nenin 7 të KEDNJ-së, është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Ky parim duhet të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë që të ofrojë garanci efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar. Çdo veprë penale duhet të parashikohet me ligj dhe individi duhet të jetë objektivisht në gjendje të kuptojë përmbajtjen e normës penale dhe, nëse është e nevojshme, me ndihmën e interpretimeve gjyqësore të saj se çfarë veprimesh ose mosveprimesh do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht. Kur bëhet fjalë për mundësinë e individit për të parashikuar pasojat e veprimeve të tij, nuk është e thënë që të nënkuptohet një qartësi absolute. Ligji duhet të jetë në gjendje të ndjekë rrethanat e ndryshme dhe, për këtë arsye, një standard i një parashikueshmërie të arsyeshme është i mjaftueshëm (*shih vendimet nr.32, datë 30.05.2023; nr.16, datë 15.06.2009; nr.14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Nocioni “ligj” nënkupton disa

kushte cilësore, sidomos ato të mundësisë së qasjes dhe të parashikueshmërisë. Këto kushte cilësore duhet të përmbushen si për përkufizimin e një vepre penale, ashtu edhe për masën e dënimit që ajo nënkupton, ose për shtrirjen e saj (*shih vendimin nr. 32, datë 30.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Me arsyetimin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Lidhur me vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, jurisprudenca kushtetuese ka pranuar se arsyetimi i kufizuar i tyre nuk cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit dhe është tregues i faktit që kërkuesi nuk ka ngritur argumente ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Gjithashtu, Gjykata ka vënë në dukje se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*), ndërsa çështja e vlerësimit, e dobishmërisë dhe e rëndësisë së provave në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, në rastin në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se pretendimi kryesor i kërkuesit gjatë gjykimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe në ankimin kushtetues individual lidhet me interpretimin që GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bërë përmbajtjes së nenit 260 të KP-së për veprën penale të korrupsionit pasiv. Sipas tij, duke e cilësuar marrëdhënien seksuale si “përfitim të parregullt”, këto gjykata i kanë dhënë konceptit penal një përmbajtje të re që nuk del nga teksti i ligjit. Duke mbajtur në konsideratë këto pretendime, Mbledhja e Gjyqtarëve do të verifikojë në vijim nëse interpretimi që gjykatat e zakonshme i kanë bërë dispozitës në fjalë përmban gabime faktike ose ligjore, të tilla që vënë në dyshim të drejtën kushtetuese të kërkuesit për të mos u dënuar pa ligj, si dhe nëse arsyetimi i vendimeve gjyqësore është në përputhje me standardet kushtetuese.

35. Në këtë drejtim, Mbledhja e Gjyqtarëve sjell në vëmendje paraprakisht se neni 3 i Konventës Penale për Korrupsionin e Këshillit të Evropës, i ratifikuar me ligjin nr. 8778, datë 26.04.2001, përcakton kuptimin e korrupsionit pasiv të zyrtarëve publikë kombëtarë, duke parashikuar si të tillë “kërkimin ose marrjen nga cilido prej zyrtarëve publikë, direkt ose indirekt, të *çfarëdolloj avantazhi* që nuk i takon, për vete ose për të tjerë, ose pranimin e një oferte, ose premtimi apo avantazhi të tillë për të vepruar ose për të mos vepruar në ushtrim të funksioneve të tij/saj”. Ndërsa sipas nenit 1, për qëllimet e kësaj Konvente, në konceptin e “zyrtarit publik” përfshihen edhe “kryebashkiakët”. Po kështu, sipas raportit shpjegues të Konventës, korrupsioni, është ryshfeti dhe çdo sjellje tjetër në lidhje me personat të cilëve u janë besuar përgjegjësi në sektorin publik ose privat, të cilët shkelin detyrat që rrjedhin nga statusi i tyre si zyrtarë publikë, të punësuar në sektorin privat, agjentë të pavarur ose marrëdhënie të tjera të atij lloji dhe që synojnë të marrin përparësi të padrejta të çdo lloji për veten ose për të tjerët. Përcaktimi si vepra penale i veprimeve të korrupsionit pasiv të zyrtarëve publikë synon të sigurojë në veçanti që administrata publike të funksionojë siç duhet, në mënyrë transparente, të drejtë, të paanshme e në përmbushje të interesave publikë, me qëllim mbrojtjen e besimit të qytetarëve në administratën e tyre, si dhe të vet zyrtarëve nga manovra të mundshme kundër tyre (*shih pikat 24, 32 dhe 40 të këtij raporti*).

36. Në legjislacionin shqiptar, korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë parashikohet nga neni 260 i KP-së, i cili përcakton se “Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt apo i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt, nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet”. Mbledhja e Gjyqtarëve vë në dukje se me ligjin nr. 9275, datë 16.09.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”, përmbajtja e kësaj dispozite është ndryshuar nga “Marrje e mitës”, e cila parashikonte si të tillë marrjen e shpërblimeve, dhuratave ose përfitimeve të tjera prej punonjësit të ngarkuar me një funksion shtetëror ose në një shërbim publik e në ushtrim të tyre, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me funksionin apo shërbimin ose për të përdorur ndikimin pranë autoriteteve të ndryshme për t’i siguruar çdo personi favorizime, dallime, vende e pune e përfitime të tjera, në “Korrupsioni pasiv i zyrtarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”. Sipas relacionit të projektligjit përkatës, ndryshimet e propozuara kanë pasur si qëllim elementet bashkëkohore dhe karakteristikat e formave të korrupsionit aktiv dhe pasiv të kryera nga funksionarët publikë, duke harmonizuar në

këtë mënyrë titullin dhe përmbajtjen e kësaj dispozite me parashikimet e Konventës Penale për Korrupsionin.

37. Nga sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se neni 260 i KP-së ka pësuar ndryshime, duke zgjeruar konceptin e objektit të korrupsionit dhe duke e përkufizuar atë si çdo përfitim të parregullt të ardhur si rrjedhojë e veprimeve ose mosveprimeve të kryera nga funksionari që lidhen me funksionin e tij. Në këtë drejtim, Mbledhja e Gjyqtarëve rithekson se, ashtu siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, në parim është e pamundur që normat të hartohen në mënyrë të tillë që të parashikojnë çdo rast praktik të së ardhmes, ndaj mbetet detyrë kryesore e gjykatave që kuptimin e ligjit ta plotësojnë natyrshëm gjatë zbatimit praktik të tij, duke përdorur metoda të qëndrueshme interpretimi (*shih vendimin nr. 34, datë 20.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndaj, në këndvështrim të kësaj jurisprudence, ndërsa vlerëson se dispozita në fjalë nuk përmban paqartësi në kuptimin kushtetues, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon të verifikojë arsyetimin e gjykatave të zakonshme, pra se si e kanë interpretuar ato ligjin.

38. Në këtë drejtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar që veprimet e kryera nga kërkuesi përbëjnë elementet e veprës penale të korrupsionit pasiv të të zgjedhurit vendor. Kjo, pasi koncepti i mitës, ryshfetit dhe përfitimit të parregullt ose të padrejtë nuk mund të kenë karakter objektiv dhe kualifikimi i tyre si të tilla përcaktohet rast pas rasti, duke pasur parasysh dobinë e përvetësuar nga subjekti pasiv i veprave penale të korrupsionit. Kjo do të thotë se, rast pas rasti, prokuroria dhe gjykatat duhet të vlerësojnë nëse kanë qenë e nevojshme mita, ryshfeti, përfitimi i padrejtë ose i parregullt në raport me subjektin pasiv të veprës penale të korrupsionit. Nëse ky subjekt provohet se ka fituar dobi materiale ose jomateriale, atëherë shkaku kryesor se pse subjekti aktiv dhe ai pasiv i kësaj veprë penale kanë hyrë në marrëdhënie kriminale do të konsiderohet se plotëson kriteret ligjore për t'u konsideruar juridikisht mitë, ryshfet ose përfitim i padrejtë dhe i parregullt. Po sipas GJKKO-së së Apelit, figurat e veprave penale të korrupsionit të parashikuara në KP kanë synuar të penalizojnë çdo ves vullneti të funksionarit publik që lind nga përfitimi personal prej ushtrimit të pushtetit dhe çdo identifikim rast pas rasti i shkakut që ka vesuar vullnetin e ushtruesit të pushtetit publik, duke e formësuar atë nisur nga motivet e përfitimit personal të padrejtë, duhet të konsiderohet se përbën mitë, ryshfet ose përfitim të parregullt dhe të padrejtë. Në rastin objekt gjykimi, marrja në mënyrë të përsëritur nga kërkuesi e shërbimeve seksuale prej shtetases A.K. ka qenë shkaku kryesor dhe përcaktues i formësimit të vullnetit të tij, si kryetari i Bashkisë së Kukësit, për të premtuar dhe për të siguruar mbështetjen administrative dhe financiare të kësaj bashkie për projektin e propozuar nga A.K. Po kështu,

shërbimet seksuale i janë dhënë kërkuessit nga A.K. për të mundësuar mbështetjen administrative dhe financiare të bashkisë për projektin e saj (*shih paragrafët 127-130 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

39. Në vijim, Kolegji Penal e ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e GJKKO-së së Apelit, me arsyetimin se, për qëllime të identifikimit të natyrës faktike dhe ligjore të faktit penal, edhe marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale mund të përbëjnë juridikisht mitë, ryshfet ose përfitim të padrejtë ose të parregullt. Megjithatë, për t'u konsideruar të tilla, duhet të plotësohet edhe elementi i paligjshmërisë kriminale në përvetësimin e tyre, duke nënkuptuar se këto marrëdhënie duhet të jenë ofruar ose përfituar nga subjekti aktiv ose pasiv i veprës penale të korrupsionit me faj, domethënë me qëllimin për të përfituar një shërbim publik (nga subjekti aktiv i korrupsionit) ose për të dhënë një shërbim të tillë (nga subjekti pasiv i korrupsionit). Në këtë drejtim, sipas Gjykatës së Lartë, GJKKO-ja e Apelit ka dhënë një arsyetim të plotë dhe shterues në vendimmarrjen e saj (*shih paragrafin 29 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

40. Në analizë të vendimmarrjeve të këtyre gjykatave, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuessi, GJKKO-ja e Apelit ka interpretuar përmbajtjen e nenit 260 të KP-së, duke treguar qartë se pse fakti penal që i atribuohet atij përfshihej brenda parashikimeve të kësaj dispozite, veprimet konkrete të kryera prej tij, shkaqet se përse ato binin ndesh me ligjin dhe përfshiheshin në elementet materiale të figurës së veprës penale të korrupsionit pasiv. Kërkuessi ka marrë përgjigje të arsyetuar në këtë drejtim edhe nga Gjykata e Lartë, e cila, me të njëjtin arsyetim, ka sqaruar veprimet të cilat përfshihen në fushëveprimin e veprës penale, për të cilën kërkuessi është dënuar. Në vendimmarrjet e tyre, gjykatat kanë treguar me qartësi faktin penal dhe ligjin e zbatueshëm, si rezultat i të cilave është dhënë vendimi penal i dënimit. Ato kanë analizuar dhe kanë argumentuar edhe për sa i takon qëllimit të dispozitës, i cili përfshin çdo lloj përfitimi të parregullt, përfshirë edhe ato me natyrë seksuale gjatë ushtrimit të detyrës nga funksionari i lartë shtetëror ose i zgjedhuri vendor. Në vlerësimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve, interpretimi i ligjit nga ato gjykata nuk rezulton me gabime faktike ose ligjore, që të vërë në dyshim se kërkuessi është dënuar pa ligj.

41. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimet e kërkuessit për cenimin e parimit të mosdënimit pa ligj të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit janë haptazi të pabazuara.

### *C. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë*

42. Kërkuesi ka pretenduar se GJKKO-ja e Apelit e ka deklaruar fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 260 i KP-së, duke bërë një interpretim të zgjeruar të anës objektive dhe subjektive të figurës së kësaj vepre. Në rastin konkret, provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se projekti nuk ishte objekt i një marrëveshjeje korruptive dhe nuk ishte dhënë asnjë favor për të. Gjatë gjykimit në gjykatat e faktit është provuar vazhdimësia e një marrëdhënieje konsensuale pa qëllime përfitimi. Po kështu, mungojnë edhe elementet e anës objektive dhe asaj subjektive të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, pasi në rastin konkret nuk ka veprim të kundërligjshëm. Një marrëdhënie seksuale konsensuale nuk përbën mitë ose avantazh të njëanshëm, nuk ka vlerë të matshme, nuk lidhet me ushtrimin e funksionit, si dhe nuk është e ndaluar nga ligji. Në këtë situatë, ajo nuk mund të përbëjë “përfitim të parregullt” në kuptim të nenit 260 të KP-së dhe as “shpërdorim detyre” në kuptim të nenit 248 të këtij kodi, sepse mungojnë elementet e anës objektive të këtyre veprave penale. Në dhënien e vendimit, GJKKO-ja e Apelit është mbështetur në deklaratat e të bashkëpandehurës A.K. të marra përpara se ajo të akuzohej, duke i vlerësuar si dëshmi dhe si deklaratat që e inkriminonin vetë atë. Edhe Gjykata e Lartë ka vlerësuar se fajësia është provuar me prova të mjaftueshme, por nuk ka identifikuar se cilat janë ato.

43. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim kushtetues ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 4 të KPP-së, i cili përcakton gjithashtu se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Në jurisprudencën kushtetuese parimi i prezumimit të pafajësisë është elaboruar në drejtim të faktit se gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin, për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Gjykatat duhet të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur, dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 14, datë 13.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë pretendimet e kërkuesit, Mbledhja e Gjyqtarëve do të verifikojë nëse në procesin penal të zhvilluar ndaj tij gjykatat e zakonshme kanë respektuar garancitë kushtetuese me natyrë procedurale të lidhura me parimin e prezumimit të pafajësisë.

45. Në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë, e ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale të shpërdorimit të detyrës të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Sipas gjykatës, për shkak të marrëdhënies që ishte krijuar midis kërkuesit dhe shtetasës A.K. duket qartë se ai ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit në angazhimin e marrë përsipër pas kryerjes së marrëdhënies seksuale, për të ndikuar në dhënien e projektit “Kafshët e pastreha dhe ndihma humane që duhet t’u japim këtyre kafshëve”, edhe pse nuk ishte kompetencë e tij funksionale. Sipas asaj gjykate, kërkuesi ka vendosur në dispozicion strukturën administrative në varësi të tij, të paktën në dy episode, për t’i shërbyer partneres së tij, gjë që del nga insistimi i zëvendëskryetarit të Bashkisë së Kukësit G.Gj. për të kontaktuar shtetasen A.K. për projektin që do të përfitohej me porosi të kërkuesit. Po sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, edhe nëse do të merrnin të mirëqenë pretendimin e prokurorisë, se dhënia e projektit në fjalë nuk është kompetencë funksionale e kryetarit të bashkisë, por është kompetencë e këshillit bashkiak, veprimi që ka kryer kërkuesi kualifikohet në figurën e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së (*shih faqet 100-102 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

46. Ndërsa GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet të ndryshohet dhe kërkuesi të deklarohet fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 260 i KP-së. Sipas asaj gjykate, marrja në mënyrë të përsëritur nga kërkuesi e shërbimeve seksuale prej shtetasës A.K. ka qenë shkak kryesor për të premtuar dhe për të siguruar mbështetjen administrative dhe financiare të Bashkisë së Kukësit për projektin e propozuar nga A.K. Sipas GJKKO-së e Apelit, shërbimet seksuale përbëjnë përfitimin e padrejtë dhe të parregullt të dhënë nga shtetasja A.K. dhe të përfituar nga kërkuesi në këmbim të realizimit të projektit të saj. Më tej, GJKKO-ja e Apelit ka analizuar parashikimin e nenit 260 të KP-së “*për të kryer ose për të mos kryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij*”. Sipas asaj gjykate, funksionari publik, titullar ose epror, mban përgjegjësi penale për korrupsion pasiv edhe kur, duke shfrytëzuar kompetencat ligjore dhe autoritetin e tij, ndikon në veprimtarinë e organeve të tjera brenda hierarkisë institucionale për realizimin e përfitimit të paligjshëm, kur provohet se ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim përfitimin e padrejtë të mitës ose ryshfetit. Mbi bazën e arsyetimit për sa më sipër, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se premtimi dhe nisja e vënies në dispozicion e shtetasës A.K. për miratimin e projektit të kërkuar nga ajo strukturave administrative të Bashkisë së Kukësit, konkretisht kryetarit dhe zëvendëskryetarit, përbën formën objektive sesi kërkuesi ka ushtruar pushtetin publik të dhënë nga Kushtetuta dhe ligji për funksionarin publik të zgjedhur vendor, atë të Kryetarit të Bashkisë së Kukësit, si rezultat i përfitimit të padrejtë dhe të

parregullt nga shtetasja A.K., konkretisht kryerja prej saj e shërbimeve seksuale më 23.05.2023 dhe më 06.06.2023 (*shih faqet 69-72 të vendimit të GJKKO-së së Apelit*). Në arritjen e konkluzionit lidhur me fajësinë e kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit është bazuar në të dhënat e përfituara nga procesverbalet: i) “Për këqyrjen dhe marrjen e pamjeve filmike”, datë 16.06.2023; ii) “Për këqyrjen e të dhënave elektronike, datë 17.06.2023; iii) “Për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijëni për veprën penale”, datë 17.06.2023; iv) “Për këqyrjen dhe transkriptimin e pamjeve filmike”, datë 22.06.2023; v) “Për këqyrjen dhe marrjen e dokumenteve”, datë 20.06.2023 etj.

47. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, GJKKO-ja e Apelit, në arritjen e konkluzionit lidhur me fajësinë e tij për faktin penal të cilësuar se vepra penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, të parashikuar nga neni 260 i KP-së, është bazuar në të gjithë materialin provues (aktet e hetimeve paraprake), duke vlerësuar veçmas fuqinë provuese të secilës provë dhe gjithashtu në harmoni me njëra-tjetrën, pra duke kryer një analizë të ndërsjellë të të gjitha provave të administruara, me qëllim arritjen e një konkluzioni të drejtë për akuzën penale të atribuar të gjykuarit. Sipas Kolegjit Penal, vendimi i fajësisë së kërkuesit nuk është bazuar vetëm ose kryesisht në deklaratimet e të bashkëpandehurës A.K., por edhe në prova të tjera, si të dhënat e përftuara nga këqyrja e pajisjeve elektronike, këqyrja dhe marrja e pamjeve filmike, provat shkresore, deklaratimet e personave të tjerë etj. Po sipas Kolegjit Penal, GJKKO-ja e Apelit ka arritur në një përfundim logjik dhe të argumentuar për përfshirjen e kërkuesit në krimin e korrupsionit pasiv, bazuar në rrethana fakti objektive, të çmuara në harmoni dhe në përputhje me nenet 152 dhe 383 të KPP-së, si dhe standardin e kërkuar nga neni 4 i KPP-së (*shih paragrafët 24, 26 dhe 34 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

48. Në këndvështrim të sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se gjykatat e zakonshme kanë mbajtur në konsideratë prezumimet e fakteve për të cilat kërkuesi akuzohej përkundrejt interesit që rrezikohej për shkak të natyrës dhe llojit të veprës penale në raport me ashpërsinë e masës së dënimit. Si prokuroria, ashtu edhe GJKKO-ja e Apelit, edhe Gjykata e Lartë, kanë përcaktuar prezumimet e fakteve bazuar në të dhëna të sakta, të rëndësishme dhe në përputhje me njëra-tjetrën. Në vlerësimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve, GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë përmbushur detyrimet e tyre kushtetuese për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave. Këto gjykata kanë arritur në përfundimin se kërkuesi ishte autor i veprës penale të korrupsionit pasiv, duke analizuar për këtë qëllim përmbajtjen e provave të shqyrtuara dhe duke shpjeguar sesi ato lidheshin me njëra-tjetrën, pa i dhënë ndonjëherë prej tyre vlerë të

paracaktuar. Ato kanë përcaktuar fajësinë e tij përtej dyshimeve të arsyeshme, bazuar në një sërë provash, si këqyrja e pajisjeve elektronike, këqyrja dhe marrja e pamjeve filmike, provat shkresore, deklaratimet e personave që kishin dijeni për veprën penale, nga përmbajtja e të cilave është analizuar dhe arsyetuar mjaftueshëm, duke i dhënë përgjigje të arsyetuar kërkuesit për garancitë ligjore procedurale për vlerësimin e provave. Po kështu, në kundërshtim nga sa kërkuesi pretendon, nuk rezulton që gjatë gjykimit gjykatat të kenë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi dhe prezumimet e nxjerra për faktet nuk rezultojnë të paarsyeshme. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë* është i pabazuar.

49. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

## MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak të çështjes që i përket ankimit kushtetues individual të paraqitur nga kërkuesi Safet Gjici, me objekt shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve gjyqësore nr. 8, datë 07.02.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë; nr. 25, datë 24.06.2024 të GJKKO-së Apelit; nr. 00-2025-1446, datë 25.09.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, jemi kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësojmë se çështja duhej të kalonte për shqyrtim në seancë plenare, mbështetur në argumentet e mëposhtme.

2. Në vlerësimin e kriterëve paraprake të legjitimitit, shumica ka arritur në përfundimin se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi pretendimet për cenimin e së drejtës së mosdënimit pa ligj të lidhur me standardin e arsytimit janë haptazi të pabazuara. Sipas shumicës, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, gjykatat e faktit kanë interpretuar nenin 260 të KP-së, duke treguar se cili ishte fakti penal që i atribuohet atij, cilat ishin veprimet konkrete të kryera nga ai dhe përse ato veprime binin ndesh me ligjin, siç kërkonte figura e veprës penale të korrupsionit pasiv dhe se interpretimi i ligjit nuk rezulton me gabime faktike ose ligjore, që të vërë në dyshim të drejtën e mosdënimit pa ligj të kërkuesit (*shih paragrafin 40 të vendimit*).

3. Nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës, pasi vlerësojmë se interpretimi i nenit 260 të KP-së duhet të mbështetet në përmbajtjen dhe formulimin e vet dispozitës, kuptimi i së cilës, sidomos në mungesë të materialeve nga *travaux preparatoires* të cilat do të ndihmonin gjyqtarin në zbulimin e kuptimit të vërtetë të dispozitës përmes interpretimit qëllimor, nuk mund të arrihet plotësisht pa iu referuar rregullave bazë gjuhësore të sintaksës dhe semantikës së fjalëve. Jemi gjithashtu të mendimit se qëndrimi i shumicës bie ndesh edhe me parimin e ligjshmërisë në të drejtën penale. Konkretisht, dispozita parashikon si element të figurës së veprës penale “*kërkimin ose marrjen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çdo lloj përfitimi të parregullt*”, formulim, i cili, sipas vlerësimit tonë, nuk mund të shtrihet përtej kuptimit të tij të qartë dhe të drejtpërdrejtë, duke përfshirë në të edhe marrëdhëniet seksuale konsensuale midis të rriturve. Dhënia e një kuptimi të tillë do të përbënte interpretim të zgjeruar të normës penale, në kundërshtim me parimin “*nullum crimen, nulla poena sine lege*”. Për më tepër, nëse qëllimi i ligjvënësit do të kishte qenë kriminalizimi edhe i “marrëdhënieve seksuale” si formë “përfitimi të parregullt”, ai do ta kishte parashikuar këtë në mënyrë të qartë dhe të shprehur në tekstin e dispozitës. Mungesa e një përcaktimi të tillë nuk mund të plotësohet nëpërmjet interpretimit të zgjeruar nga gjykata, pasi kjo do të binte ndesh me jurisprudencën kushtetuese, sipas së cilës dispozitat ligjore duhet të jenë të

qarta, në mënyrë që individi të jetë i aftë të parashikojë, pasojat ligjore të veprimeve të tij. Për rrjedhojë, në vlerësimin tonë, qëndrimi i shumicës tejkalon kufijtë e interpretimit të lejueshëm të dispozitës penale.

4. Në këtë këndvështrim, çështja e parashtruar nga kërkuesi, i cili pretendon se është dënuar për veprime, të cilat janë vlerësuar nga gjykatat e zakonshme se bien ndesh me detyrën shtetërore, merr natyrë kushtetuese, sepse lidhet drejtpërdrejt me parimin e ligjshmërisë, që siç ka pohuar Gjykata, detyron që çdo vepër penale duhet të parashikohet me ligj dhe individi duhet të jetë objektivisht në gjendje, nëse është e nevojshme edhe me ndihmën e interpretimeve gjyqësore, të kuptojë përmbajtjen e normës penale, pra se çfarë veprimesh ose mosveprimesh do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht (*shih vendimin nr. 16, datë 15.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky parim synon të garantojë që çdo individ ta përshtatë sjelljen e tij sipas legjislacionit penal dhe të mos gjendet përpara kundërveprimeve shtetërore të paparashikueshme. Në kushtet kur dënimet penale ndërhyjnë drejtpërdrejt te liritë dhe të drejtat themelore, neni 29 i Kushtetutës ia ka ngarkuar vetëm ligjvënësit miratimin abstrakt të veprave dhe dënimeve penale (*shih vendimin nr. 32, datë 30.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në këtë drejtim, theksojmë se, për sa i takon termit “ligj” të përdorur në Kushtetutë dhe në përgjithësi në legjislacion, Gjykata ka pohuar se ka raste që ky term nënkupton një interpretim të gjerë, duke përfshirë edhe aktet nënligjore. Kjo ka të bëjë me rastet që u përkasin rregullimeve të përgjithshme, që nënkuptojnë përdorimin e termit “ligj” në kuptim të legjislacionit ose të së drejtës dhe jo aktit të organit ligjvënës. Për të përcaktuar nëse ndodhemi përpara njërit ose tjetrit variant, rëndësi ka të sqarohet konteksti, nga i cili del qëllimi i normës (*shih vendimet nr. 7, datë 27.02.2013; nr. 20, datë 11.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, sipas Gjykatës, vetëm ligji mund ta përcaktojë krimin dhe të parashikojë masën e dënimit që nënkupton se veprat penale dhe masat e dënimit për ndëshkimin e tyre duhet të jenë të përkufizuara qartësisht me ligj. Duke pasur parasysh rëndësinë që ka legjislacioni penal dhe sidomos efektin e dënimeve penale për të drejtat e njeriut, normat penale duhet të jenë të parashikueshme dhe të qarta, pasi krijojnë lidhje të drejtpërdrejtë me dy prej parimeve kryesore të së drejtës penale, siç janë parimi i ligjshmërisë (mosdënimi penalisht për vepra që nuk parashikohen shprehimisht në ligj) dhe ndalimi i zbatimit të ligjit penal me analogji (*shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 39, datë 15.12.2022; nr. 24, datë 04.05.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë qëllim, Gjykata, ka theksuar se përcaktimi i veprave penale, llojeve dhe masave të dënimeve është në diskrecion të

ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre në raste konkrete është në diskrecion të gjykatës (*shih vendimet nr. 32, datë 30.05.2023; nr. 47, datë 26.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Nën këtë optikë, sjellim në vëmendje se ndonëse Gjykata nuk ka si detyrë që t'u zërë vendin gjykatave të zakonshme në vlerësimin dhe cilësimin juridik të veprave, ose të shprehet rreth përgjegjësisë penale individuale të individit, funksioni i saj në vështrim të nenit 29 të Kushtetutës është të verifikojë nëse dënimi penal që i është caktuar individit mbështetet në një bazë ligjore të qartë.

7. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, vërejmë se GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë, ndonëse kanë arritur në përfundimin se veprimet e kryera nga kërkuesi përbëjnë veprën penale të korrupsionit pasiv, të parashikuar nga neni 260 i KP-së, ato nuk duket se i kanë dhënë përgjigje shteruese pretendimit se përse “marrëdhënia seksuale” konsiderohet “përfitim i parregullt”, duke e barazuar atë me konceptin e “ryshfetit” ose “mitës”. Në këtë mënyrë, nga shqyrtimi *prima facie* i ankimit kushtetues individual dhe i vendimeve gjyqësore, duket se gjykatat nuk kanë arsyetuar mjaftueshëm në drejtim të dënimit të kërkuesit dhe as nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit të tij për parimin e mosdënimit pa ligj. Po kështu, edhe pse është gjendur përpara një shkaku në rekurs me natyrë kushtetuese, që kishte të bënte me parimin kushtetues, atë të mosdënimit pa ligj, dhe megjithëse ka pranuar që për përcaktimin juridik të konceptit të “ryshfetit”, “mitës” ose “përfitimit të padrejtë” edhe marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale mund të përbëjnë juridikisht “mitë”, “ryshfet” ose “përfitim të padrejtë ose të parregullt”, Gjykata e Lartë është shprehur për çështjen e kërkuesit nëpërmjet një arsytimi të kufizuar, me argumente që duken të jenë formaliste dhe të paanalizuara, duke mos u dhënë përgjigje pretendimeve të tij për qëllime të identifikimit të natyrës faktike dhe ligjore të faktit penal të atribuar atij.

8. Për sa më lart, çmojmë se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së mosdënimit pa ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, nuk rezultojnë të jenë haptazi të pabazuara, ndaj, për këtë shkak, Mbledhja e Gjyqtarëve duhej të kishte vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Genti Ibrahim, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Anëtarë.